



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.5.2023

Nr: 447

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOALICIONIT PËR REFORMA INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA (KRIIK), PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 5.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, me adresë Rruga “Ymer Kurti”, Tiranë dhe me përfaqësues z. Premto Gogo;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Data: 5.5.2023 Nr: 447
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vëzhguesve afatshkurtër të Koalicionit për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI